



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIK OF KOSOVA

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

Në mbështetje të nenit 13 paragrafi 2, nenin 14 paragrafi 2, nënparagrafi 1, 2 dhe 3 dhe paragrafi 3, të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;

Duke marre parasysh specifikat e veçanta të punës në Prokuroritë e Republikës së Kosovës dhe nevojën e përmbushjes së mandatit dhe detyrave të punës;

Në pajtim me Vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovë, Nr. 19/2013, të datë 29 janar 2013, për plotësim-ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2011, të datës 05 dhjetor 2011, për përdorimin e telefonave fiks dhe mobil në prokuroritë e Republikës së Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovë, nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV
Nr.06/2013

PËR PËRDORIMIN E TELEFONAVE FIKS DHE MOBIL NË PROKURORITË E
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE KËSHILLIT PROKURORIAL

Neni 1
Qëllimi

Udhëzimi Administrativ ka për qëllim përcaktimin e rregullave për përdorimin efikas dhe ekonomizimin e shpenzimeve për telefonat fiks dhe mobil në Prokuroritë e Republikës së Kosovës dhe Këshillit Prokurorial (në tekstin e mëtejshëm "Prokuroritë"), duke përcaktuar lartësinë e shumës mujore për shpenzime telefonike.

Neni 2

E drejta për kartela mbushëse të telefonit mobil

Të drejtë për mbushje të telefonit mobil kanë: Kryeprokurori i Shtetit, Anëtarët e KPK që nuk janë prokuror, Prokurorët e Zyrës së kryeprokurorit të Shtetit ("ZKPSH), Zëvendës Kryeprokurorja dhe Prokurorët e Prokurorisë Speciale ("PS"), Kryeprokurori dhe Prokurorët e Prokurorisë së Apelit ("PA"), Kryeprokurorët dhe Prokurorët e Prokurorive Themelore ("PTH"), Drejtori i Përgjithshëm i SZKPSH, Drejtori i Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë ("NJSHP"), Menaxherët e Zyrave në PSH dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës ("KPK") ("Menaxherët"), Zëdhënësi/ja e Prokurorisë (Zëdhënësi/ja"), Administratorët e Prokurorive ("Administratorët"), Zyrtar tjerë në ZKPSH ,varësisht nga natyra e punës dhe sipas Vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të SZKPSH.

Neni 3

E drejta për telefonin fiks

Të drejtë për përdorimin e telefonave fiks kanë të gjithë zyrtarët e cekur në nenin 2 të këtij Udhëzimi dhe çdo i punësuar në Prokurori, varësisht nga natyra e punës dhe miratimi nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 4

Shpenzimet për telefonat mobil me kartelë mbushëse (prepaid)

1. Lartësia e lejuar e shpenzimeve mujore për telefonat mobil me kartelë mbushëse (prepaid) është:

a.	Kryeprokurori i Shtetit	100.00 €
b.	Prokurorët e ZKPSH	30.00 €
c.	Anëtarët e KPK që nuk janë prokuror	30.00 €
d.	Zëvendës Kryeprokurorja e PS	40.00 €
e.	Prokurorët e PS	30.00 €
f.	Kryeprokurori i PA	25.00 €
g.	Prokurorët e PA	20.00 €
h.	Kryeprokurorët e PTH	25.00 €
i.	Prokurorët e PTH	20.00 €
j.	Drejtori i Përgjithshëm i PSH	80.00 €
k.	Drejtori i NJSHP	60.00 €
l.	Administratorët	20.00 €
m.	Asistenti/ja e Kryeprokurorit të Shtetit	15.00 €
n.	Zëdhënësi/ja	30.00 €
o.	Menaxherët	30.00 €
p.	Zyrtar tjerë në PSH, sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje	10.00 - 30.00 €

2. Të gjithë të punësuarit në sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës do të përfshihen në rrethin (Klubi CUG në operatorin Vala-PTK) dhe të gjithë këta me njëri-tjetrin dhe me disa institucione të tjera, do të mund të komunikojnë gjatë tërë muajit me shpenzime mujore siç parashihet me marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet SZKPSH dhe PTK-VALA. Fatura e përbashkët për të gjithë zyrtarët e përfshirë në CUG do të paguhet nga Zyra për Buxhet dhe Financa e Sekretariatit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 5 Shpenzimet mujore për telefon fiks

1. Për zyrtarët e poshtëshënuar, lartësia e lejuar e shpenzimeve mujore për telefon fiks është:

a.	Kryeprokurori i Shtetit		pa-kufizim
b.	Prokurorët e PSH	deri në	20.00 €
c.	Zëvendës Kryeprokurorja e PS	deri në	30.00 €
d.	Prokurorët e PS	deri në	20.00 €
e.	Kryeprokurori i PA	deri në	30.00 €
f.	Prokurorët e PA	deri në	20.00 €
g.	Kryeprokurorët e PTH	deri në	30.00 €
h.	Prokurorët e PTH	deri në	20.00 €
i.	Drejtori i Përgjithshëm i PSH	deri në	30.00 €
j.	Drejtori i NjSHPP	deri në	30.00 €
k.	Administratorët	deri në	20.00 €
l.	Asistenti/ja e kryeprokurorit të Shtetit,	deri në	20.00 €
m.	Zëdhënësi/et	deri në	25.00 €
n.	Menaxherët e PSH dhe KPK	deri në	20.00 €

2. Zyrtarët tjerë, në të gjitha Prokuroritë dhe KPK, nëse tejkalojnë shpenzimet mujore për telefon fiks mbi shumën e përcaktuar 10.00 € duhet të deklarojnë dhe arsyetojnë shpenzimet në formularin e posaçëm.

Neni 6 Procedura e pajisjes me telefona fiks

Çdo zyrtar i Prokurorive, që ka nevojë zyrtare për telefon fiks, duhet të plotësojë formularin-kërkesën për pajisje me telefon dhe linjë telefonike, të kërkojë aprovimin nga Kryeprokurori i Prokurorisë ku punon zyrtari dhe pas nënshkrimit nga Kryeprokurori duhet të dorëzojë kërkesën për miratim tek Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 7

Instalimi dhe mirëmbajtja

1. Zyra për Teknologji Informativë ("TI") e Prokurorisë së Shtetit, duhet të përkujdeset për mirëmbajtjen e rrjetit të telefonisë fikse, në të gjitha Prokuroritë.
2. Instalimi apo zgjerimi i rrjetit të telefonisë fikse brenda objekteve të Prokurorive mund të bëhet vetëm nën mbikëqyrjen e zyrës për TI të Prokurorisë së Shtetit.
3. Në rast të defektit në rrjetin e telefonisë fikse, zyrtari përkatës është i obliguar ta lajmërojë zyrën për TI.

Neni 8

Përgjegjësia për shfrytëzimin e telefonit zyrtar

1. Shpenzimet e parapara me këtë Udhëzim lejohen me qëllim të përmbushjes së mandatit ligjor dhe kryerjes së detyrave zyrtare, ndërsa nga zyrtarët kërkohet që telefonin ta përdorin me përgjegjësi.
2. Të gjitha shpenzimet që tejkalojnë shumat e përcaktuar me këtë Udhëzim, duhet të deklarohen dhe arsyetohen në formularin e posaçëm. Në rast se konstatohet se janë të krijuar shpenzime të pa-arsyeshme, zyrtari/ja i/e ngarkuar me telefon duhet të kompensoj vet shumën e tejkaluar dhe mund të vendosën kufizime në qasje.
3. Shfrytëzuesit e telefonisë fikse, në Prokuroritë ku ekziston mundësia e komunikimit me CENTREX, janë të obliguar të përdorin këta numra gjatë komunikimit me të gjitha institucionet e përfshira në këtë sistem.

Neni 9

Hartimi i raportit tremujor për shpenzime

Zyra për TI, në bazë të raporteve të pranuar nga Prokuroritë, harton raportin përmbledhës tremujorë të shpenzimeve të telefonisë fikse dhe ia dërgon Drejtorit të Përgjithshëm. Raporti përmbledhës duhet të dorëzohet deri me datë 5 të çdo tremujori.

Neni 10
Shpenzimet shtesë për nga natyra dhe lloji i punës

1. Për shpenzimet të cilat për nga natyra dhe lloji i punës kalojnë shumën mujore të përcaktuar me këtë Udhëzim Administrativ duhet miratim i veçantë.
2. Kërkesa e arsyetuar me shkrim sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të përcillet për miratim tek Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 11
Akumulimi i shpenzimeve të telefonit

Shpenzimet e telefonit nuk mund të akumulohen dhe vlera e shpenzimeve mbyllet në ditën e fundit të muajit.

Neni 12
Planifikimi i shpenzimeve të telefonit

Shpenzimet e telefonit duhet të planifikohen në buxhetin e vitit fiskal të Prokurorit të Shtetit.

Neni 13
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ 04/2011, i datës 05 dhjetor 2011 " për përdorimin e telefonave fiks dhe mobil në prokuroritë e Republikës së Kosovës" ..

Neni 14
Hyrja në fuqi

Udhëzimi Administrativ hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe nënshkrimit nga Kryetari.

Prishtinë, me 29 janar 2013



Ismet Kabashi
Ismet Kabashi
Kryetar i Këshillit Prokurorial